




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 254/2020  
Datë: 18 nëntor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 105 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 67 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në mbledhjen e 242-të, të mbajtur me datë 18 nëntor 2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Znj. Hysnije Gashi, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj, propozohet tek Presidenti i Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtares, për shkak të përfundimit të mandatit, me arritjen e moshës së pensionimit, me datë 16 dhjetor 2020.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Konform nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, gjyqtares Hysnije Gashi, sipas fuqisë ligjore i përfundon mandati i gjyqtares pasi që e njëjta me datë 16 dhjetor 2020, arrin moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

KGJK, bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës, të liroj nga detyra gjyqtaren Hysnije Gashi.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skender ÇOÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit të KGJK-së.